

MANUAL PËR PESHKIMIN ARGËTUES NË AFERSI TË ZONËS SË MBROJTUR DETARE KARABURUN - SAZAN

Project partners:



MANUAL PER PESHKIMIN ARGËTUES NE AFERSI TE ZONES SE MBROJTUR DETARE KARABURUN-SAZAN

PËRMBAJTJA

HYRJE	1
PESHKIMI ARGËTUES	2
ZMD-JA, PESHKIMI DHE BIODIVERSITETI	13
REFERENCAT	28

Project partners:



HYRJE

Mjedisi bregdetar ne Detin Mesdhe dhe vecanerisht ai i ZMDëve është duke pësuar tronditje ne shkalle rritese nga aktivitetet argetuese, perfshire ketu edhe peshkimin argetues, i cili mbulohet dhe qendron nen hije per shkak te interest ekskluziv kundrejt peshkimit tregetar (e.g. Badalamenti et al. 2000; Lloret & Rivera 2008). Sektoret e peshkimit argetues dhe artizanal (profesional) shpesh jane ne gare per burimet e kufizuara bregdetare dhe per kete arsye planet e meaxhimit bregdetar kane nevojte te inkorporojne te dy sektoret, per te cilet është e nevojshme te kuptuarit e permasave njerezore dhe ato te peshkimit. Pmavaresisht studimeve te shumta mbi peshkimin artizanal ne ujerat bregdetar te Mesdheut (p.sh. Colloca et al. 2004; Morales-Nin et al. 2010), studimet mbi peshkimin argetues jane duke munguar ne krahasim me ate artizanal. Ne Detin Mesdhe, aktivitetet e peshkimit artizanal karakterizohen nga peshkatarët tregetar qe operojne ne bark ate vogela, te cilet shfrytezojne zonat afer bregdetit, duke perdorur nje numer te larte veglash dhe teknikash peshkimi (te cilat ndryshojne ne menyre sezonale), tipikisht te menaxhueshme nga nje peshkatar i vetem apo nje cift peshkatarësh dhe qe kane subjekt nje diversitet te larte llojesh (Gómez et al. 2006). Keto aktivite peshkimi kane qene historikisht nje burim i madh ushqimi, punesimi dhe benefitesh ekonomike ndaj banoreve te fshatrave bregdetar ne Mesdhe.

Megjithese peshkimi ne shkalle te vogel është ende i rendesishem per disa komunitete (rreth 80% e flotes se Mesdheut është perbere nga mjete te vogla peshkimi, te cilat nuk shkojne me shume se 12 m ne gjatesi; Komisioni Evropian 2018), kjo tiplogji peshkimi është duke pësuar rënie ne shume pjese te Mesdheut (Colloca et al. 2004; Gómez et al. 2006). Peshkimi argetues (PA) ne Mesdhe është nje aktivitet popullor ne natyre ne zonat

Project partners:



bregdetare, ku nje numer ne rritje i banoreve local dhe turisteve peshkojne per kenaqsi dhe krijojne nje impakt te madh ne ekonomite lokale dhe rajonale (Lloret et al. 2008; Cerdà et al. 2010; Font & Lloret 2011).

PESHKIMI ARGETUES

Pergjithesisht, PA mund te identifikohet si nje seri zeniesh/peshkim jo-tregetare (p.sh. jo per shitje, shkembim apo tregetim); i motivuar nga zenia e peshkut nga kenaqesia, gezimi apo per sport. Me konkretisht dhe formalisht, Cacaud (2005) e identifikoi PA-ne si “gjithe tipet e aktiviteteve te peshkimit perfshire ketu aktivitetet e peshkimit sportiv te realizuar nga nje individ i vetem, me apo pa nje barke, per qellime qetesie dhe qe nuk perfshin shitjen e peshkut apo te organizmave te tjere ujore”. Ky perkufizim per me teper perfshin faktin se aktivitetet e PA-se nuk jane te motivuara nga varesia tek peshku i zene si ushqim. Ne kuader te perkufizimit me te gjere, dikush mund te kryej nje kategorizim te metejsheem te PA-se ne ate amatorial, turistik dhe sportive/gar ate peshkimit argetues; ku secila permabn nje qellim specific dhe identifikohet si vijon:

Peshkimi amator, per qellim te kesaj forme te permbledhur identifikohet si peshkimi i pa organizuar per hobi. Perkufizohet si i pa organizuar ne kuptimin qe nuk eshte i asociuar me vente specifike apo garime. Zeniet nga peshkimi amator madje edhe leshohen perseri (catch & release) ose ralle mbahen per konsum personal.

Peshkimi sportiv pershkruhet si nje “aktivitet i organizuar ku perfshihet garimi i lire midis peshkatareve per te kapur peshkun me te madh per disa specie, numrin me te

Project partners:



larte te individeve apo peshen e pergjithshme me te madhe ne varesi te rregullave ne secilen nga garat” (SFITUM, 2004).

Peshkimi turistik mund te nenkuptohet si nje aktivitet peshkimi i realizuar nga nje pale e trete, e cila organizon nje ekspedite peshkimi per turistet. Peshkimi turistik mund te realizohet nga peshkatarët tregetar (*pescaturismo*) apo profesionistet e peshkimit argetues (“charter”); nje ndryshim kryesor perfaqsohet nga tipi i barkes se perdorur (barke e peshkimit tregetar kundrejt barke turistike). Qellimi i peshkimit *chartereshte* kryesisht peshkimi; ndersa ne konceptin e *pescaturismo*, qellimi nuk eshte vetem peshkimi, por gjithashtu praktikimi i zhytjes *snorkelling*, konsumi ne bord i peshkut te gatuar ne menyre tradicionale dhe pikerisht te shijuarit e dites ne nje varke ne mes te detit.

Përveç klasifikimit të bazuar në qellimin përkatës të PA-së të paraqitur më lart, PA mund gjithashtu të karakterizohet bazuar në lokacionin dhe mjetet e përdorura në aktivitet. Në peshkimin argetues detar mund të identifikohen 4 grupe bazike: peshkimi në këmbë *pêche à pied*, përgjatë bregut, në barkë dhe peshkimi në ujë; me nënkategorizime të mëtejshme (si paraqitet në Figuren 1).

Project partners:






Figura 1. Peshkimi argetues detar sipas kategorive ne vendet e Mesdheut; pershtatur nga Cacaud, 2005 dhe Giakoumi et al., 2017.

Peshkimi argetues identifikohet si **“peshkimi i kafsheve ujore (kryesisht peshq), te cilet nuk perbejne burimin kryesor per individin per te sigurua nevojat ushqimore dhe pergjithesisht nuk shiten apo tregetohen ne eksport, merkatot lokale apo**

Project partners:



merkaton e zeze.”PA operon ne brendesi te nje sfere konkurence me peshkataret tregetar, te cilet mund te mbledhin nga i njeiti stok. PA mund te siguroj te ardhura dhe mundesi te ndryshme; me nje politike te promovuara gjeresisht te zenieve dhe leshimeve ne kete sektor, PA mundeson nje shumefishim te vleres per peshkun e peshkuar aktualisht. Keqmenaxhimi i RF mund te shkaktoj problem ne ceshtje qe lidhen me mbrojtjen e biodiversitetit, perfshire ketu: shfrytezimin e larte te stokut, zeniet selective te peshqve si trofe ‘trophy fish’ (dhe per pasoje te shkaktojne spostime ne strukturen e popullates), shkaterrim te habitatit, zenie te paqellimshme dhe mortalitet gjate leshimit/perfshire semundje, introduktimin e specieve te huaja/jo endemike dhe shqetesime ne mjedis. Me te tilla shqetesime do te ishte e nevojshme te orientohej i tille sector drejt qendrushmerise mjedisore ne nivel nderkombetar, nepermjet kuptimeve te ndryshme, si lishensmi I peshkatareve me grep dhe atyre me barka, vendosja e sezoneve te mbylljes se peshkimit dhe nxjerrja e kufizimeve ne permasa per speciet dhe cantat e peshkatareve.

LEGJISLACIONI KOMBETAR

Ne legjislacionin kombetar Shqipetar, ligji i pare i peshkimit perfaqsohet nga Ligji mbi Peshkimin dhe Akuakulturen, N. 7908, date 05.04.1995, i cili u zevendesuar nga Ligji mbi Peshkimin N. 64 i 2012-es. Ne ligjin e meparshem, dy kategorit te aktiviteteteve te peshkimit jane listuar ne ligj, te cilat perfaqsohen nga peshkimi profesional (sipas perkufizimit te ligjit) nenkupton peshkimin per qellime ekonomike dhe peshkimi spotiv – peshkimi per qellime argetuese dhe defryese.

Ne ligjin aktual (te 2019-es) “Ligji mbi Peshkimin”, Neni 28 (tiplogjite e aktiviteteteve te peshkimit) nenkuptohet se aktivitetet e peshkimit jane te kategorizuar si me poshte:

Project partners:



- a) **Peshkim tregetar;**
- b) **Peshkim çlodhës-argëtues;**
- c) **Peshkim për qëllime studimore dhe shkencore,**

ku peshkimi tregetar kategorizohet në nën-kategori të tjera (sipas Nenit 29, tipet e aktiviteteve të peshkimit tregetar) si më poshtë:

- 1) **Peshkim Tregetar Profesional dhe**
- 2) **Peshkim Tregetar Artizanal**

Në këtë manual përshihen të gjitha pjesët relative të legjislacionit kombëtar në fuqi rreth peshkimit argetues/sportiv dhe aktiviteteve bashkelidhur.

Sipas rregullores No 1 datë 29.03.2005 – për aplikimin e legjislacionit mbi peshkimin dhe akuakulturën këtu raportohen nënë rreth peshkimit argetues/sportiv:

Licensat për peshkimin sportiv – Neni 61

1. Licensat për peshkim sportiv/argetues nga barkat e peshkimit (në përputhje me nenin 23 të ligjit) mund të jepen ndaj organizatave të peshkimit sportiv apo personave të interesuar, të cilët përmbushin kriteret e përmendura më poshtë në pikën 3 të këtij neni, në këtë rregullore.

2. Një lishencë për peshkim sportiv leshohet në bazë të pikës 1 dhe mund të autorizojë ushtrimin e peshkimit sportiv me më shumë se një barkë peshkimi. Në këtë rast duhet të specifikohet në lishencë:

- a. Numri maksimal i barkave të peshkimit të autorizuar për të ushtruar të tillë aktivitet.

Project partners:



- b. Numri maksimal i diteve te peshkimit per te ushtruar aktivitetin nga secila barke peshkimi pergjate vitit.
 - c. Numri maksimal i personave ne bord ne secilen nga barkat e peshkimit gjate ushtrimit te aktivitetit te peshkimit sportiv.
3. Organizatat e autorizuar per te ushtruar peshkimin sportive/argetues bazuar ne lishencat e leshuara nga ministria, jane te detyruara:
- a. te paraqesin ne drejtorite perkatese dokumentacionin per cdo barke peshkimi qe ka per qellim te perdoret per peshkim sportive/argetues;
 - b. te disponojne nje kopje te legjislacionit mbi peshkimin sportive/argetues per cdo barke peshkimi dhe per te cilen autorizohet te ushtrohet i tille aktivitet;
 - c. te paraqes certifikaten e kualifikimit per te drejtuar mjetin lundrues, te cilin do e perdore per peshkim sportiv/argetues;
 - d. te paraqes te dhena statistikore lidhur me zeniet gjate ushtrimit te peshkimit sportiv/argetues per cdo barke.
4. Ne cdo rast, nje lishence per peshkim sportive percakton zonen ku lejohet ushtrimi i te tille aktiviteti peshkimi.
5. **Ndalohet tregeshitja e organizmave ujore te zene gjate ushtrimit te peshkimit sportive/argetues.**

Pajisjet e lejuara gjate peshkimit sportiv – Neni 62

Peshkimi sportive lejohet te ushtrohet vetem **me grepa, kallama peshkimi dhe pushke**

Project partners:



per peshkim nenujor. Ne peshkimin nenujor lejohet peshkimi me pushkevetem nese ushtrohet me maske dhe tub.

Ndalimet gjate peshkimit sportiv – Neni 63

1. ne peshkimin sportive/argetues:

a. nuk lejohet perdoren me shume se 5 grepa(kallama peshkimi) per peshkatar ne ujerat detar dhe tre grepa (kallama peshkimi) ne ujera te ndryshem nga ata detar;

b. nuk lejohet te peshkohet me burim drite, pervec rastit kur perdoret elektrik dore apo llampe per peshkim nenujor;

c. Gjate lundrimit nenkuptohetse nuk lejohet cdo pajisje peshkimi apo rrjete qe perdoret ne peshkimin profesionalapo te perdoret rrjete trate fundore, rrjeta me rrethim, draga, rrjeta grumbulluese dhe monofilament, set linjash per specie peshqish migrues.

d. nuk lejohet peshkimi me fuzhnje ne te gjitha kategorite ujore.

e. nuk lejohet peshkohet gjate dites nje sasi me madhe se tre kg peshk per peshkatar, pervec rasteve kur pasha e nje individi te vetem i tejkalon te tilla limite.

f. nuk lejohet peshqimi i molusqeve, krustaceve dhe llojeve te tjera, te cilat ndalohen nga aktet ligjore ne fuqi te nxjerra nga Ministria e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural.

2. Te gjitha ndalimet e parashikuara per peshkimin profesional gjithashtu aplikohen per peshkimin sportiv.

Project partners:



Ne perditetimet e Ligjit mbi Peshkimin (ligji nr. 4/2019, date 07.02.2019) lidhur me peshkimin artizanal jane perfshire gjithashtu nenet, si me poshte:

Peshkimi çlodhës - argëtues Neni 38

1. Peshkimi çlodhës - argëtues konsiston në zënien/mbledhjen e një sasie peshku dhe organizmash të tjerë ujorë, nëpërmjet përdorimit të veglave dhe pajisjeve të lejuara për peshkimin çlodhës - argëtues dhe që nuk ka për qëllim final shitjen/shkëmbimin apo tregtimin e peshkut.
2. Në asnjë rast dhe për asnjë arsye, ushtrimi i peshkimit çlodhës - argëtues nuk duhet të ndërhyjë, të pengojë, të rrezikojë apo të vështirësojë peshkimin tregtar.

Kategoritë e peshkimit çlodhës - argëtues - Neni 39

Peshkimi çlodhës - argëtues ndahet në tri kategori të veçanta, si më poshtë:

- a) *Peshkim amator*, peshkim i kohës së lirë, me grepa ose mjete të tjera, peshkimi jo-tregetar, i paorganizuar i palidhur me ngjarje ose gara të përcaktuara, pa mjete lundruese.
- b) *Peshkim sportiv*, peshkim i organizuar që përfshin garimin e lirë midis peshkatarëve për të zënë individin (peshkun) më të madh të disa llojeve, numrin më të madh të individëve ose peshën më të madhe të përgjithshme në varësi të rregullave të çdo gare të veçantë.

Project partners:



c) *Peshkim turistik*, peshkim i kryer nga peshkatarë profesionistë ose nga profesionistë të peshkimit çlodhës, të konsideruar si palë e tretë, e cila organizon ekspeditat e peshkimit.

Autorizimi për peshkimin çlodhës - argëtues – Neni 40

1. Individët, vendas dhe/ose të huaj, që ushtrojnë peshkimin çlodhës – argëtues, përveç atyre që marrin pjesë në peshkimin sportiv, pajisen me autorizim peshkimi.
2. Lloji, numri maksimal i autorizimeve për çdo komunë/bashki/qark, gjatë një vitikalendarik, si dhe kriteret që duhen përmbushur për lëshimin/marrjen e autorizimit të peshkimit përcaktohen nga **ministri ne Ministrine e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural**.
3. Për peshkimin amator, institucionet që verifikojnë plotësimin e kriterëve të lejimit, janë organet e pushtetit vendor.
4. Kriteret, që duhet të përmbushë një mjet lundrues për t'u konsideruar si mjet turistik, përcaktohen nga autoritetet klasifikuese të përcaktuara në legjislacioni përkatës.
5. **Autorizimi për peshkimin amator** lëshohet nga autoriteti përgjegjës i qeverisjes vendore.
6. **Autorizimi për peshkimin turistik** lëshohet nga **ministra** ose **çdo ent tjetër i autorizuar prej saj**.
7. Përfshihen nga pika 6 e këtij neni autorizimet për peshkimin amator në ujërat e

Project partners:



brendshme, të shpallura si zona të bashkëmenaxhimit, të cilat jepen nga organizatat përgjegjëse të bashkëmenaxhimit.

Lloji i autorizimit për peshkimin amator dhe turistik – Neni 41

- 1. Autorizimi për peshkimin amator mund të jetë afatgjatë ose afatshkurtër.**
- 2. Autorizimi për peshkimin turistik është afatshkurtër.**
- Autorizimi është afatgjatë kur vlefshmëria e tij shtrihet gjatë gjithë vitit kalendarik në të cilin është lëshuar. Të drejtën për të aplikuar, me qëllim pajisjen me autorizim për peshkim amator, e kanë vetëm shtetasit, shqiptarë ose të huaj, që janë anëtarë të shoqatave kombëtare të peshkimit çlodhës - argëtues..
- Autorizimi është afatshkurtër kur vlefshmëria e tij përfshin një periudhë kohore jomë të gjatë se 30 ditë. Kjo periudhë fillon nga data e lëshimit të autorizimit.
- Shtetasit e huaj kanë të drejtë të aplikojnë dhe të pajisen vetëm me autorizimeafatshkurtra.

Detyrimi për mbajtjen e autorizimit të peshkimit çlodhës - argëtues – Neni 42

- Autorizimi për peshkimin çlodhës - argëtues përdoret vetëm prej personit, në emër të të cilit është lëshuar.
- Mbajtësi i autorizimit, gjatë ushtrimit të aktivitetit çlodhës - argëtues, është i detyruar të mbajë gjithmonë me vete autorizimin përkatës, si dhe t'ua tregojë atë personave të

Project partners:



autorizuar në bazë të këtij ligji, me kërkesën e parë.

Tarifa e autorizimit të peshkimit çlodhës - argëtues – Neni 43

1. Për t'u pajisur me autorizim për peshkimin çlodhës - argëtues paguhet tarifa e caktuar.
2. Tarifat, në varësi të llojit të peshkimit, përcaktohen me urdhër të përbashkët të ministrit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrit të Financave.

Mjetet e përdorura për peshkimin çlodhës – argëtues

(ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 4/2019, datë 7.2.2019) – Neni 44

1. Mjetet që përdoren për peshkimin çlodhës-argëtues dhe mënyra e lëshimit të autorizimit përcaktohen me udhëzim të ministrit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
2. Ministri përcakton, gjithashtu, edhe sasinë maksimale të peshkut, që mbajtësi i autorizimit, për këtë lloj peshkimi, mund të zërë gjatë një dite (24 orë).

Ndalimet në peshkimin çlodhës – argëtues– Neni 45

Gjatë ushtrimit të aktivitetit të peshkimit çlodhës - argëtues ndalohen:

- a) peshkimi gjatë periudhës **nga perëndimi i diellit deri në agim;**

Project partners:



b) peshkimi me **pushkë nënujore** prej personave **nën 16 vjeç**;

c) **shitjae** peshkut të kapur gjatë këtij aktiviteti.

Kontrolli i autorizimeve për peshkimin çlodhës - argëtues – Neni 46

Shoqatat kombëtare të peshkimit çlodhës - argëtues (degët e tyre në qarqe), **autoriteti përgjegjës i qeverisjes vendore**, si dhe **Inspektorati i Peshkimit**, **bashkërendojnë punën për të kontrolluar** zbatimin e kushteve të autorizimit për peshkimin çlodhës - argëtues.

Kontrolli i peshkimit çlodhës – argëtues– Neni 47

1. Të gjitha masat mbrojtëse dhe menaxhuese, që zbatohen për peshkimin tregtar në det dhe ujëra të brendshme, janë **njësoj të zbatueshme edhe për peshkimin çlodhës - argëtues**.
2. **Ministria e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural** merr masat përkatëse për kontrollin e peshkimit çlodhës - argëtues në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
3. Të dhënat, që rezultojnë nga ky kontroll, mbahen në një bazë të dhënash të posaçme.
4. **Ministria e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural**, nëse vlerëson se ndikimi i peshkimit çlodhës - argëtues është i konsiderueshëm, pasi ka marrë edhe mendimin e KKKSHTESË, mund të vendosë zbatimin e masave të veçanta menaxhuese në lidhje me autorizimet dhe deklarinimin e zënieve

Project partners:



ZMD-JA, PESHKIMI DHE BIODIVERSITETI

Ne menyre qe te krijohet dhe promovohen aktivitetet e peshkimit te qendrueshem ne ZMD-en e Karaburun-Sazanit eshte esenciale qe peshkataret artizanal dhe profesionist (*perfshire ketu edhe ata te peshkimit argetues*) dhe brezat e ardhshem te peshkatareve te kene njohuri te mjaftueshme lidhur me rregullat dhe lidhin mi peshkimin, te cilat jane te permbledhura ne Tabelen 1 dhe 2.

Tabela 1. Lista e legjislacionit kombetar rreth peshkimit te qendrueshem me interes per ZMD-en e Karaburun-Sazanit.

Legjislacioni Kombetar	Viti	Objektivat dhe pasojat relevante per menaxhimin e ZMD-es
Ligji Nr. 64/2012, e dates 31.05.2012, “Mbi Peshkimin”	2012	Rregullon peshkimin, menaxhimin e tij, siguron ruajtjen e gjallesave detare dhe atyre te ujerave te brendshem dhe rregullon “zonat e mbrojtura te peshkimit”
Rregullorja Nr 1, i dates 29.03.2005, “Per aplikimin e legjislacionit mbi peshkimin dhe akuakulturen”	2005	Ndalon peshkimin rreth grykederdhjeve te lumenjve, peshkimin dhe akuakulturen ne pjesen e jashtme te Karaburunit(deri ne 1 milje apo derin ne thellesin 50 m), anijet me trata fundore dhe trata per peshkimin e pelagjikeve ne gjirin e Vlores, peshkimi ne kanalet e lagunes.

Project partners:



Tabela 2. Permbledhje e zonave te mbrojtura per nga nenet dhe rregulloret e peshkimit.

Nenet dhe Rregulloret	Zonat e mbrojtura nga peshkimi	Legjenda e hartes	Siperfaqja (km ²)	% e ujerave territorial
Rregullorja Nr. 1, 2005: Neni 43/3/j	Zone buferike ne distancen 1 milje nga bregdeti apo deri ne izobatin 50 m, jashte bregut te Karaburunit – qe nga Kepi i Gjuhezes deri tek Rrugjet e Bardha	Ndalim i plote i peshkimit	6,50	0,11%
Rregullorja Nr. 1, 2005: Neni 45/1	Zona buferike brenda rrezes prej 2 km nga goja e lagunes detare	Kanalet e lagunes	45,00	0,76%
Rregullorja Nr. 8, 2009: Neni 12/2	Zone buferike prej 0.3 miljesh nga bregdeti, ku eshte i ndaluar perdorimi i dragave hidraulike	Nuk lejohet perdorimi i dragave hidraulike	220,00	3,69%
Rregullorja Nr. 8, 2009: Neni 12/3	300 m zone buferike nga linja e brgdetit, ku peshkimi me njica fundore dhe rrjeta me rrethim eshte i ndaluar.	Nuk lejohet perdorimi i njicave fundore dhe rrjetave me rrethim	143,00	2,40%

Gjithashtu, me poshte jane integruar gjithe nenet relevante nga rregulloret dhe perditesimet tek Ligji mbi Peshkimin, te cilet kane per qellim te zhvillojne peshkimin e qendrueshem ne ZMD. Ne perputhje me *rregulloren No 1 date 29.03.2005 -per aplikimin e legjislacionit mbi peshkimin dhe akuakulturen, ne kapitullin VII jane te perfshire gjithe Ndalimet Ligjore ne Peshkim:*

Project partners:



Zonat e mbrojtura nga peshkimi- Neni 43

1. Ne zonat e ujerave te mbrojtur (detar apo ujera te brendshem) eshte e ndaluar te ushtrohet cod aktivitetet i cili mund te demtoj ruajtjen e karakteristikave mjedisore te ketyre zoanve dhe/apo iniciativat e se ardhmes te shpalljes se tyre.

Vecanerisht eshte i ndaluar:

a. Peshkimi, grumbullimi dhe demtimi i specieve te kafsheve dhe bimeve ashtu si edhe ekstraktimi i mineraleve dhe objekteve me vlere arkeologjike;

b. Perdorimi i tratave fundore, apo rrjetave te tjera me rrethim ne nje distance 1 (nje) milje detare nga kufiri i zones ne mbrojtje.

c. Transformimi i habitateve gjeofizike, kimis se ujit dhe karakteristikave biologjike.

d. Aktivitetet me kuptim publicitar;

e. Futjen e armeve, eksplozivit dhe materialeve shkaterruese dhe atyre qe bien ne renoja.

f. Lundrimi nepermjet perdorimit te motoreve;

g. Cdo hedhje mbeturinash (te ngurta apo ne gjendje te lenget);

...

j. Eshte i ndaluar cdo aktivitet peshkimi dhe akuakulture ne pjesen e jashtme te bregut te Karaburunit qe nga Kepi i Gjuhezes deri ne rruget e Bardha (Palase) ne distancen 1 milje detare nga bregu dhe 50 m thellesi ne rastin kur kjo thellesi arrihet ne distance me te vogel nga bregu.

Project partners:



k. Ministri i Ministrise se Bujqesise dhe Zhvillimit Rural bashkepunon me Ministrin e Mjedisit, bazuar ne studimet e biodiversitetit te ujit, ujerave detar dhe atyre te brendshem, aprovon dhe shpall zona te reja te mbrojtura nga peshkimi.

l. Ministri i Ministrise se Bujqesise dhe Zhvillimit Rural bashkepunon me Ministrin e Mjedisit **me qellim transformimin e zonave te mbrojtura nga peshkimi ne Parqe Detare/Rezerva Detare/Parqe te Ujerave te Brendshem.**

Peshkimi i ndaluar- Neni 48

1. Eshte i ndaluar te peshkosh, mbash ne bord, te transbordosh nga barka/anija, me qellim zbarkimin dhe tregetimin, ne cdo periudhe, zone me cfaredo kuptimi dhe mjetesh speciet me poshte:

- Peshkaqenet – *Cetorhinus maximus*, *Carcharodon carcharias*.

- Lopa e detit – *Mobula mobular*.

- Gureshpuesi – *Lithophaga lithophaga*.

2. Eshte e ndaluar te peshkohet ne cdo periudhe te vitit, zone dhe cdo lloj mjeti peshkimi gjitaret e detit (delfinet, balenat, fokat, e tje).

5. Eshte i ndaluar perdorimi i tratave fundore apo i rrjetave te fiksuara per peshkimin e specieve:

- Toni i bardhe (*Thunnus alalunga*),

- Toni i kuq (*Thunnus thynnus*),

Project partners:



- Peshku shpat (*Xiphias gladius*),
 - Peshkaqenet (*Hexanchus griseu*, *Cetorhinus maximus*, *Alopiidae*; *Carcharhinidae*; *Sphyrnidae*; *Isuridae*; *Lamnidae*).
6. Eshte i ndaluar peshkimi me trata fundore dhe dragat ne zone me shume se 1000 m thellesi.
7. Eshte i ndaluar perdorimi per peshkim dhe me pas mbajtje ne bord te peshqve te zene me parangall, ku grepat ndodhen ne gjatesi me te vogel se 10 cm dhe gjeresi me te vogel se 4, 5 cm per ato barka peshkimi qe perdorin parangall apo mbajne ne bord nje sasi te caktuar peshku shpat (*Xiphias gladius*) prej me shume se 20% te zenieve totale..
8. Eshte e ndaluar perdorimi i rrjetave per peshkimin e pelagjikeve te medhenj.
9. Eshte i ndaluar **peshkimin me parangall nga 1 Tetori deri ne 31 Janar per speciet:** toni i bardhe (*Thunnus alalunga*), toni i kuq (*Thunnus thynnus*), peshku shpat (*Xiphias gladius*), peshkaqenet (*Hexanchus griseu*, *Cetorhinus maximus*, *Alopiidae*; *Carcharhinidae*; *Sphyrnidae*; *Isuridae*; *Lamnidae*).

Ndalimin i peshkimit te disa llojeve ne periudha dhe zona te caktuara -Neni 49

Eshte i ndaluar peshkimi me cdo instrument peshkimi dhe kuptimi, mbajtja ne bord, transbordimi, me qellim zbarkimin e specieve ne periudhat respective dhe zonat e percaktuar:

...

8. Drejtoria e Peshkimit percakton nepermjet nje urdheri specific **Kohen e peshkimit te**

Project partners:



bivalveve/moluskeve.

9. Eshte i ndaluar aktiviteti i peshkimit te bivalveve/moluskeve gjate te Shtunes dhe te Dieles, zyrtarisht pushim, pergjate gjithe vitit.

10. Eshte i ndaluar per periudha me te gjata kohore, ne brendesi te zonave te plazhit, ne vecanti, peshkimi i midhjeve dhe vongolave nga Maji ne Shtator.

Matja e permasave te organizmave - Neni 50

1. Gjatesia e peshkut matet nga skaji i kokes (ne afersi te gojes) deri ne ekstremitetin me te larget (lobi) apo bishti (pjesa kaudale), kur ky nuk eshte i ndare ne dy lobe.
2. Gjatesia e krustaceve matet nga fillimi i syve (karpaksi) deri ne ekstremitetin e pasem te trupit, perfshire bishtin.
3. Permasat e midhjeve/bivalveve i referohen gjatesis maksimale apo diamterit maksimal te guaskes se tyre.

Permasat minimale te organizmave ujqor -Neni 51

1. Eshte i ndaluar te peshkohet dhe te shiten organizma ujqor me permasa me te vogla se ato me poshte per cdo lloj:

a. Peshqit

- Merluci, *Merluccius merluccius* 20 cm
- Lakuriqi apo Tripendeshi, *Micromesistius* spp., 20 cm

Project partners:



- Moteli, *Trisopterus* spp, *Gaidropsarus* spp., 20 cm
- Levreku, *Dicentrarchus labrax* 25 cm
- Qefull, *Mugil* spp., *Liza* spp., *Chelon* spp 20 cm
- Kocja, *Sparus aurata* 20 cm
- Fagri, *Pagrus pagrus* 20 cm
- Sargu, *Diplodus* spp. 15 cm
- Lithrinat, *Pagellus* spp., 12 cm
- Dentali, *Dentex* spp. 25 cm
- Bogu, *Boops boops* 10 cm
- Salpa, *Sarpa salpa* 12 cm
- Barbuni, *Mullus* spp. 11 cm
- Rufjoi, *Epinephelus* spp, *Polyprion* spp. 45 cm
- Korbi, *Sciaena* spp., *Umbrina* spp. 25 cm
- Stavridhi Atlantikut, *Trachurus* spp. 12 cm
- Gofa, *Seriola* spp 30 cm
- Lica, *Lichia amia* 30 cm
- Stavridhi, *Scomber* spp. 20 cm
- Palamidhi, *Sarda sarda* 30 cm
- Sardelja, *Sardina pilchardus* 10 cm
- Aciuga, *Engraulis encrasicolus* 10 cm
- Sardelja e madhe, *Sardinella aurita* 12 cm
- Shproti, *Sprattus sprattus* 10 cm
- Maridhet, *Spicara* spp 8 cm
- Toni i kuq, *Thunnus thynnus* 70 cm

Project partners:



- Toni i bardhe, *Thunnus alalunga* 40 cm
- Toni vogel, *Euthynnus alletteratus* 30 cm
- Peshku shtize, *Xiphias gladius* 100 cm
- Peshqit pellumb, *Mustelus* spp. 30 cm
- Peshkaqenet, *Squalus* spp, *Scyliorhinus* spp, *Prionace* spp. 40 cm
- Rajat, *Raja* spp. 30 cm
- Skadhinat e buta, *Squatina* spp. 40 cm
- Rajat elektrike, *Torpedo* spp. 30 cm
- Ngjale deti, *Conger conger* 30 cm
- Peshqit kitarre, *Rhinobatos* spp. 30 cm
- Gjuheza, *Solea* spp. 20 cm
- Shojza, *Platichthys flessus* 15 cm
- Peshqit pjate (si rombi) *Bothus* spp., Gjuheza e eger *Arnoglossus* spp. 30 cm
- Rombet *Scophthalmus* spp, *Psetta* spp, *Lepidorhombus* spp. 30 cm
- Peshku jatagan, *Lepidopus caudatus* 40 cm
- Barakuda evropiane, *Sphyræna* spp 25 cm
- Kovaci, *Zeus faber* 15 cm
- Peshqit gjel, *Trigla* spp., *Aspitriglia* spp. 15 cm
- Lofa apo Peskatricia, *Lophius piscarorius* 30 cm
- Aterinat, *Atherina* spp 8 cm

b. *Krustacet*

- Karkalec deti thellesie, *Panaeus kerathurus* 7 cm
- Karkaleci violete, *Aristeus antennatus* 7 cm

Project partners:



- Karkaleci i kuq, *Aristaemorphia foliacea* 6 cm
- Karkaleci roze i thellesive, *Parapenaeus longirostis* 10 cm
- Skampi, *Nephrops norvegicus* 30 cm
- Astaket, *Homarus* spp. 30 cm

c. *Cefalopodet*

- Kallamaret, *Loligo* spp. 25 cm
- Totanet, *Ilex* spp 30 cm
- Sepia, *Sepia officinalis* 20 cm
- Oktapodi i zakonshem, *Octopus vulgaris* 0.5 kg

d. *Midhjet bivalvore*

- Midhja e zeze, *Mytilus galloprovincialis* 5.0 cm
- Vongola me vija, *Venus gallina* 2.3 cm
- Vongola me rudha, *Venus verrucosa* 2.7 cm
- Telina, *Donax trunculus* 2.2 cm
- Vongola verace, *Ruditapes decussatus* 3.6 cm
- Vongola filipine, *Ruditapes semidecussatus* 3.0 cm
- Ostrika, *Ostrea* spp. 6.0 cm
- Bicaku, *Solen* spp. 8.0 cm
- Freskorja, *Pecten jacobaeus* 10.0 cm
- Fasolari, *Challista chione* 6.0 cm

2. Peshqit e permasave te vogla te kapur nepermjet perdorimit te rrjetave me rrethim, si

Project partners:



sardelet, aciugat, lejohet te peshkohen deri ne 20 % nen permasat minimale perkatese (pika 1 e ketij neni), por jo me te vogla se 7 cm ne gjatesi.

3. Ne cdo konfeksion te prodhimit te peshkut lejohet nje **tolerance per molussqet bivalvor** me permasa me te vogal se ato te paraqitura me sipër, **por jo me shume se 10%** e tyre, sipas pikes 1 te ketij neni.

Sasia maksimale ditore per molusqet bivalvore - Neni 52

1. Zeniet ditore maksimale per cdo barke peshkimi, bazuar ne nenin 53 jane te percaktuar si me poshte:

- Vongola me vija, *Venus gallina* 600 kg
- Fasolari, *Challista chione* 500 kg
- Telina, *Donax trunculus* 100 kg
- Kapesantet apo freskoret ne total 300 kg
- Ostrikat, *Ostrea* spp 100 kg

2. Per cdo peshkatar profesionist te pajisur me license mbi mbledhjen e moluseve bivalvore ne det dhe lagunat bregdetare, **eshte e ndaluar te tejkaloj sasite ditore si me poshte:**

- Bicaku, *Solen* spp. 10 kg
- Fasolari, *Challista chione* 50 kg

Project partners:



- Freskorja (kapesanta) *Pecten jacobaeus* 20 kg
- Midhja e zeze, *Mytilus galloprovincialis* 80 kg
- Ostrika, *Ostrea spp* 30 kg
- Vongola me rrudha, *Venus verrucosa* 10 kg
- Telina *Donax trunculus* 50 kg
- Vongola me vija, *Venus gallina* 40 kg
- Vongola verace, *Ruditapes decussatus* 40 kg
- Vongola filipine *Ruditapes semidecussatus* 10 kg

3. Percaktimi i sasis maksimale ditore per cdo subject do te behet ne cdo mjet te pajisur me license ne varesi te resurseve te pranishme ne cdo zone.

4. Produktet nga akuakultura jane te perjashtuar nga pika 1 dhe 2.

Ndalimi me ligj per disa forma dhe instrumenta peshkimi - Neni 58

1. Eshte i ndaluar perdorimi per peshkim apo mbajtja ne bordin e anijes/varkes te substancave toksike, narkotike, corrosive, te cilat ne rastin e bashkeveprimit mund te shkaktojn shperthim, apo pajisjeve qe mund te shkaktojn shkarkesa elektrike apo shperthime.
2. Eshte i ndaluar te peshkohet duke perdorur trata, draga e tje., ne ujerat e brendshem.
3. Eshte i ndaluar peshkimit i peshqve me trata, draga ne formen e gabia ne ujerat detar dhe te brendshem.
4. Eshte e ndaluar te vendosen instrumenta peshkimi te fiksuar, te cilet bllokojn totalisht apo pergjate rrjedhes se lumenjve drejt detit, ashtu si edhe ne rrjedhen e ujerave te

Project partners:



embel ne laguna.

5. Eshte e ndaluar te mblidhen (peshq) midhje bivalvore duke kontrolluar rendshem me shpejtesi.

Juvenilet dhe organizma te tjere uxor jane te mbrojtur sipas Nenit 10, i cili vendos *permasat minimale te peshkut*. Rregulla te posacme detajojnepermasat minimale te peshkut dhe organizmave te tjere ne ujerat detare dhe ato te brendshme, perfshire ato anadrome dhe katadrome, nen permasat e te cilave ndalohet peshkimi, mbajtja transbordimi, zbarkimi i qellimshem, tregetimi apo konsumimi.

Pamavaresisht te tilla permasave, Ministri mund te lejoj zenien e juvenileve, llojeve te peshqeve dhe organizmave te tjere, te cilet nuk jane te afte te riprodhohen, ne nje periodhe te caktuar te vitit, duke perdorur vegla peshkimi specifike, me qellim ripopullimin per mbrojtjen e specieve dhe per qellime kerkimore shkencore.

Ndalime dhe kufizime te perditesuara ne lidhje me veglat e peshkimit, llojet e peshqve, permasat minimale, e the., jane perhere duke u kryer. Permasat minimale te propozuara tregohen ne Tabelen 3, me poshte.

Tabela 3. (N. 402, date 08/05/2013 lidhur me Masat Menaxhuese per Shfrytezimin e Qendrushem te Burimeve Peshkore ne Det) te cilat vendosin permasat minimale te organizmave (TL – gjatesia totale; CL – gjatesia e karpaksit).

Speciet (emertimi shkencor)	Emri ne Shqip	Emri ne Anglisht	permasa minimale ne cm
1. Peshqit			
<i>Dicentrarchus labrax</i>	Levrek	European seabass	25 cm
<i>Diplodus annularis</i>	Sargu bishtzi	Annular seabream	12 cm

Project partners:



<i>Diplodus puntazzo</i>	Sharan	Sheephead bream	18 cm
<i>Diplodus sargus</i>	Sargu	White seabream	23 cm
<i>Diplodus vulgaris</i>	Sargua	Common two-banded sea bream	18 cm
<i>Engraulis encrasicolus</i> ¹	Acuga	European anchovy	9 cm
<i>Epinephelus</i> spp.	Kerrat	Groupers	45 cm
<i>Lithognathus mormyrus</i>	Murra	Sand steenbras	20 cm
<i>Merluccius merluccius</i> ²	Merluc	European hake	20 cm
<i>Mullus</i> spp.	Barbunët	Striped red mullet	11 cm
<i>Pagellus acarne</i>	Mormuri i eger	Axillary seabream	17 cm
<i>Pagellus bogaraveo</i>	Spalce e kuqe	Blackspot seabream	33 cm
<i>Pagellus erythrinus</i>	Spalce e kuqe	Common pandora	15 cm
<i>Pagrus pagrus</i>	Pagri	Red porgy	18 cm
<i>Polyprion americanus</i>	Kerr fundi	Atlantic wreckfish	45 cm
<i>Sardina pilchardus</i> ³	Sardelja	European pilchard	11 cm
<i>Scomber</i> spp.	Skumri	Scomber mackerels	18 cm
<i>Solea vulgaris</i>	Gjuhez kanali	Common sole	20 cm
<i>Sparus aurata</i>	Kocja	Gilthead seabream	20 cm
<i>Trachurus</i> spp.	Stavridhët	Jack mackerels	15 cm
2. Krustacet			
<i>Hommarus sgammarus</i>	Astaku	European lobster	105 mm CL 300 mm TL

Project partners:



<i>Nephrops norvegicus</i>	Skampi	Norway lobster	20 mm CL 70 mm TL
<i>Palinuridae</i>	Aragostat	Spiny lobsters	90 mm CL
<i>Parapeneus longirostris</i>	Karkaleci rozë	Deep-water shrimp	20 mm CL
3. Molusqet bivalvor			
<i>Pecten jacobaeus</i>	Midhja freskore	Mediterranean scallop	10 cm
<i>Venerupis spp.</i>		Carpet shells	25 mm
<i>Venus spp.</i>		Venus shells	25 mm

Ne menyre qe te mbrohen disa lloje peshqish dhe organizma te tjere detar, sipas Nenit 11, te vendimit te Keshillit te Ministrave mund te deklarohen zona te mbrojtura nga qellimi i peshkimit, ku synohet te krijohen kushte te favorshme per riprodhimin natyror te peshqve dhe rritjen e juvenileve dhe organizmave te tjere detar. Vendosja e kufijve dhe projektimi i zonave te mbrojtura per te permiresuar menaxhimin e peshkimit ashtu si edhe per te ndermarre masa ne mbrojtje te llojeve dhe mundesuar zhvillimin e tyre percaktohen nga vendimi i Keshillit te Ministrave, pas konsultimeve me institucionet shkencore te specializuara ne peshkim, problemet mjedisore sebashku me grupe te tjera interesi, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Per me teper, vete Neri 37 i Ligjit mbi Peshkimin (perditesuar ne ligjin nr 80/2017, date 04.05.2017) nxjerr qarte se eshte i ndaluar peshkimi, mbajtja ne bord, transbordimi, zbarkimi i qellimshem dhe marketimi apo konsumi, ne cdo sezon, zone dhe me cdo pajisje apo vegjel peshkimi dhe mjeti peshkimi (pika 1), e te tille organizmave ujqor

(vetem specie detare jane te perfshira ne kete manual):

Koralet (*Corallium spp.*);

Peshkaqenet - *Cetorhinus maximus*, *Carcharodon carcharias*;

Raja Gjigande/lopa e detit - *Mobula mobular*;

Daterit - *Lithophaga lithophaga*;

Sfungjeret e detit (*Spongidae*);

Cetacet (balenat, delfinet dhe fokat);

Breshkat e detit (*Carretta carretta*, *Chelonia mydas* dhe *Dermochelys coreacea*);

Zogjte detar.

Me vendim te Keshillit te Ministrave, tek kjo liste shtohen lloje te tjera, te cilat jane vleresuar me pare si te rrezikuara nga zhdukja. Kapitenet e mjeteve te peshkimit duhet te leshojne menjehere zogjte detar, te cilat kane ngecur aksidentalisht ne veglat e peshkimit.

Individet e lartepermendur, te cilet jane zene aksidentalisht nga mjetet e peshkimit duhet te trajtohen me kujdes ne bordin e mjetit te peshkimit dhe te leshohen ne ujera te gjalle dhe pa i demtuar ata.

Kapitenet e mjeteve te peshkimit nuk lejohen te zbarkojne llojet e lartepermendura, pervecse ne rastet kur keto specie jane te perfshira ne nje program te aprovuar per shpetimin dhe mbrojtjen e tyre, apo ne rastet kur kerkohet te krijohet mundesia per kurimin e tyre, kur ato jane te demtuara, pasi kane informuar inspektoriatin e peshkimit

Project partners:



dhe perpara se mjeti i peshkimit te hyj ne port.Gjithe llojet ujore te mbrojtura perjashtohen nga pika 1, nese ato jane te perfshira ne Nenin 30 te Ligjit mbi Akuakulturen, nr. 103/2016.

REFERENCAT

- Badalamenti F., Ramos A., Voultziadou E., Sanchez-Lizaso J.L., D'Anna G., Pipitone C. et al. (2000) Cultural and socio-economic impacts of Mediterranean protected areas. *Environmental Conservation* 27, 1– 16.
- Cerdà M., Alós J., Palmer M., Grau A.M. & Riera F. (2010) Managing recreational fisheries through gear restrictions: the case of limiting hook size in the recreational fishery from the Balearic Islands (NW Mediterranean). *Fisheries Research* 101, 146– 155.
- Colloca F., Crespi V., Cerasi S. & Coppola S.R. (2004) Structure and evolution of the artisanal fishery in a Southern Italian coastal area. *Fisheries Research* 69, 359– 369
- Font T. & Lloret J. (2011) Socioeconomic implications of recreational shore angling for the management of coastal resources in a Mediterranean marine protected area. *Fisheries Research* 108, 214– 217.
- Giakoumi, S., Scianna, C., Plass-Johnson, J., Micheli, F., Grorud-Colvert, K., Thiriet, P., Claudet, J., Di Carlo, G., Di Franco, A., Gaines, S.D., García-Charton, J.A., Lubchenco, J., Reimer, J., Sala, E., Guidetti, P., 2017. Ecological effects of full and partial protection in the crowded Mediterranean Sea: a regional meta-analysis. *Sci. Rep.* 7, 1-12.

Project partners:



- Gómez S., Lloret J., Riera V. & Demestre M. (2006) The decline of the artisanal fisheries in Mediterranean coastal areas: the case of Cap de Creus (Cape Creus). *Coastal Management* 34, 217– 232.
- Lloret J. & Riera V. (2008) Evolution of a Mediterranean coastal zone: human impacts on the marine environment of Cape Creus. *Environmental Management* 42, 977– 988.
- Lloret J., Zaragoza N., Caballero D. & Riera V. (2008) Biological and socioeconomic implications of recreational boat fishing for the management of fishery resources in the marine reserve of Cap de Creus (NW Mediterranean). *Fisheries Research* 91, 252– 259.

Project partners:

